



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada – Government  
Komuna e Drenasit  
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme  
Zyra e Prokurimit



KONTRATË PUNE - KORNIZË  
KUSHTET E PËRGJITHSHME, TË VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

**TTIULLI: LOT 2: MIRËMBAJTJA DHE PASTRIMI I RRUGËVE GJATË SEZONËS DIMËRORE NË QYTEZËN E KOMORAN-IT DHE FSHATRAT PËR' RRETH 2018/2019**

Numri identifikues: 611-17-110-221

Nr. i arkivit: 02-400-68409

Pergaditur ne Drenas: 16/11/2018

**NENI 1 PALËT NË MARRËVESHJE**

1. **KOMUNA E DRENASIT - DRENAS**, përfaqësuar nga **MENSUR GLLAREVA**, Zyrtar i Prokurimit ( më tutje "Punëdhënës")
2. **"FER PETROL"- DRENAS**, përfaqësuar nga: **MEHDI GJOKA** Drejtor ( me tutje "Kontraktues")

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit pér kryerjen e shërbimeve në vijim:

**LOT (II ) Komorani (I, II, III dhe IV), Paklek i Ri, Paklek i Vjetër, Shtrubullovi, Krajkovë (deri në Poterkë), Vasilevë, Korroticë e Epërme,Korroticë e ulët, Zabeli i Epërme,Zabel i ulët Sankoc, Fushticë e Epërme, Fushticë e Ultë, Nekoc, Kizharekë, Llapushnik-Poterk-Vukoc, Arllat- Bytyq- Gjergjicë), Negroc, Vuqak dhe në të gjitha lagjet e këtyre fshafrave të lartëcekura.**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjeter Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i sherbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjëren prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund të blejë më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara pér artikull p.sh brenda një pjese (loti) të njëjtë. Megjithatë, Autoriteti(ët) Kontraktues i përmendor në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Ofertuesi i Shërbimeve NUK do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, pér shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parapara të specifikuar dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendos të MOS blejë ASNJË nga këto sasira pér disa artikuj.

1.5 Kontrata hynë në fuqi me 16/11/2018 dhe përfundon në datën 31/03/2019.

**Neni 2 Koha e përfundimit**

2.1 Afati kohor pér kryerje të shërbimeve do të jetë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vend i kryerjes së shërbimeve do të jetë Komuna e Drenasit

**Neni 3 Çmimi**

Çmimi i kontratës që duhet të paguhet: 25,750.00 € ( Njëzetë e Pesëmijë e Shtatëqind e Pesëdhjetë euro)

3.1 Çmimet i shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bortx Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

#### Neni 4 Rendi i përparesisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparesisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlgimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvèç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlgim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shenojen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa atsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet [Shqipe] [Serbe] në tri originale, dy originale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Kësaj kontrate i bashkangjitet: Oferta financiare e Tenderuesit (Paramasa dhe paralogaria e çmimeve).

#### PJESA II E KONTRATËS

#### KUSHTET E PËRGJITHSHME

##### Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “Ofrues i shërbimeve” është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “Personeli” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “Nënkontraktuesi” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “Autoriteti Kontraktues” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “KPK” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përsitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lironë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njostimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose shërbimetorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

## Neni 5 Tatimet dhe Detyrimet

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

## Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marries së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda asfatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

#### Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsy:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përm bushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilin ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospективë dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhëniet të kontratës ose kur kontrata hyjnë fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrëgullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimi, vërsimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngashme e paparashikuar që është përpjekur kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërpërje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërpërje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërsa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mijetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mijetë të tillë alternative përvèç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### Neni 9 Ndërpërja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; shërbimet e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analogë që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofraesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofraesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofraesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofraesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofraesi i Shërbimeve nuk arrin të jep garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërpresa do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofraesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjeter me një palë të tretë në emër të Ofraesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërpresa së kontratës, do ta udhëzojë Ofraesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgjedhur në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërpresa, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofraesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofraesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofraesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërpresa së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofraesin e Shërbimeve derisa të janë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofraesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofraesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofraesit të Shërbimeve para ndërpresa së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpres kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofraesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### Neni 10 Ndërpresa e Kontratës nga Ofraesi i Shërbimeve

10.1 Ofraesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpres kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofraesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofraesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërpresa do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjeter sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofraesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërpresa sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofraesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofraesit të Shërbimeve.

#### Neni 11 Obligimet e Ofraesit të Shërbimeve

11.1 Oferuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofraesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofraes i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përmë të kontratës, ai, duke iu eksposuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofraesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe shërbimtarët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas

këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlgimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlgimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetur, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

#### Neni 12            Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

#### Neni 13            Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjikim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Sherbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Sherbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendor që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofrcesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofrcesi i Shërbimeve gjithashu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

#### Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofrcesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofrcesit të Shërbimeve.

14.2 Garacioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

#### Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofrcesi i Shërbimit

15.1 Ofrcesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofrcesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe tuajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

#### Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofrcesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofrcesi i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofrcesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofrcesi i Shërbimeve do të jepë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofrcesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh, nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofrcesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofrcesi i shërbimeve mund të informojë APP-ja për shkelje të tillë. APP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga APP.

#### Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do tëjenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofrcesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofrcesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofrcesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të

zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

#### Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të siperpërmendura, mund të jepen dëmshpërbime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetërën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### Neni 22 Dëmshpërbimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbuje Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoresh, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

### PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
Gjuha	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>Gjuha shqipe</b>
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Autoriteti kontraktues merrë për obligim që kontraktuesit t'i siguroj kushte për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuareve.
Programi i realizimit – Plani i Menaxhimit të kontratës.	12.4	Menaxherët e Kontraktuesit dhe Autoritetit kontraktues duhet ta hartojnë Planin e Menaxhimit të kontratës koform Nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës. <b>Kryetari i komunës</b> , Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 të caktuar me një vendim, Menaxherin e Projektit nga Drejtoriat për Shërbime Publike dhe Emërgjencë dhe komisionin apo organin për pranim të shërbimeve me një Vendim tjetër. Drejtoria për Shërbime Publike është e obliguar në bazë Ligjit mbi rrugë përkatesisht Neni 12 të hartoj Planin vjetor të mirëmbajtjes së rrugëve lokale gjatë sezonës dimërore dhe verore. Të dy palët obligohen të mbajnë ditarin e punës dhe nga një kopje të dorëzohen në arkivin e dosjes për pagesë. Drejtoriat për Shërbime Publike dhe Emërgjencë gjatë hartimit të Planit të menaxhimit të kontratës në bashkëpunim me menaxherët e OE duhet t'i qartësoj kërkësat e OE gjatë dorëzimit të dosjes së tenderit, varianta të prezantuara në hapje dhe të bashkangjitura paramasës dhe dosjes së tenderit. Në Planin e Menaxhimit duhet të përfshihen edhe emrat e personave kyq nga të dy palët, caktimi i punishtës ku do të vendosen pasijet, fillimin e pastrimit të rrugëve, caktimin e vendit për bartjen dhe hudhjen e mbeturinave (akullit), kyqjen e personave tjerë në Planin e Menaxhimit si, Policia e Kosovës, Zjarrfikësit etj. Të përfshihen edhe cilat rrugë janë prioritare gjatë emergjencave ekstreme, kush do t'i paguaj shpenzimet e komunikimeve, shenjave të rrezikut, nëse janë të domosdoshme etj, Në pajtim me Planin vjetor mbi mirembajtjen e rrugeve gjatë sezonës dimërore.
Programi i azhuruar dhe pagesat	12.5	Periudha për Programin e azhuruar të shërbimeve do të jetë deri më <b>31/03/2019</b> . Pagesat kryhen ashtu si raporton Menaxheri i projektit dhe Organit mbikqyrës, për shërbimet e kryera konform paramasës dhe paralogarisë. Pagesa kryhet vetëm atëherë kur ofrohet, Planin vjetor të mirëmbajtjes së rrugëve lokale gjatë sezonës dimërore, Plani i menaxhimit të kontratës (ku precizohen afatet, format, vendet e pastrimit), Fletet e ditarit të punës, situacionet për shërbimet e kryera (konform paramasës dhe paralogarisë), faturat, raportet e nënshkruara prej Menaxherit dhe Organit mbikqyrës.
Obligimet e kontraktuesit	12.6	Kontraktuesi do t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, Ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Nëse shfaqet ndonjë mosmarrëveshje lidhur me nevojën për publikim ose shpalosje për qëllime të kontratës, vendimi i Autoritetit kontraktues do të jetë final.Të gjitha shërbimet duhet t'i kryej <b>konform standardeve pët sigurime dhe çmimorës si dhe obligimet tjera që janë</b>

		<b>specifikuar në dosje të tenderit.</b>
Siguria e ekzekutimit	14.1	<p>Shuma e sigurise se ekzekutimit është <b>10 % e shumës vjetore</b> dhe do të jetë valid deri me <b>30/04/2019</b>. Siguria e ekzekutimit duhet të ofrohet nga OE në ditën e hyrjes në fuqi së kontratës.</p> <p>Kontraktuesi duhet te përfundoj shërbimet sipas dates se parapare ne nenin paraprak ne a deri me <b>31/03/2019</b> dhe te dorëzoj raportin përfundimtar te shërbimeve të kryera në fun të çdo muaji ku duhet te përbahen te gjitha detajet për shërbimet e kryera. Pageset do te kete vetem per sherbimet e kryera, ashtu si raportojnë, komisionet, organet mbikqyrëse dhe Drejtoria për Shërbime Publike, konform standardeve për smirëmbajtje dhe paramasës (çmimorës) si dhe obligimet tjera që janë specifikuar në dosje të tenderit.</p>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	<p>Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Mjetet motorike të Palës së Tretë: sipas ligjeve në fuqi</li> <li>b) Përgjegjësia e pales së tretë <b>sipas ligjeve në fuqi</b></li> <li>c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve <b>sipas ligjeve në fuqi</b></li> <li>d) Përgjegjësia profesionale <b>sipas ligjeve në fuqi</b></li> <li>e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve <b>sipas ligjeve në fuqi</b></li> </ul>
Pagesat		<p>Për t'i marrë pagesat, Kontraktuesi duhet t'i përcjellë Autoritetit të përmendorur në paragrafin 26.1 më lart:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Kontraktuesi obligohet që për shërbimet e kryera në muajin e kaluar, Faturën ta dorëzoj nga data <b>01 deri 05</b> e muajit në vazhdim ose në <b>momentin e kryejrje së shërbimeve</b>.</li> <li>b) Pagesa duhet të kryhet mundësisht menjëherë, nëse jo atëherë jo më vonë se <b>tridhjetë ditë</b> pas dorëzimit dhe pranimit të faturës.</li> </ul>
Kualiteti i Shërbimeve	17.1	<p>Shërbimet duhet të kryhen Konform standardeve të kërkua të dosje të tenderit. Nëse shërbimet janë të dobëta dhe pas tërheqjes së vërejtjes ato përsëri janë të tillë, atëherë fillohet me uljen e pagesave mujore dhe nëse prapë vazhdohet atëherë kontrata njëanshëm ndërpritet.</p> <p>OE duhet të jetë në gjendje gadishmërie 24 orë pa ndërpërre. Ditë efektive llogaritet nga ora 00:00 deri në ora 24:00 të të njëjtës ditë.</p>
Dëmet e likuiduara	19.1	<p>Dëmet e likuiduara për të gjitha Shërbimet janë 0.25 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Shërbimet është 10 % e Çmimit final të Kontratës. Me propozimin e Menaxherit të Projektit dhe aprosimin e Autorizuesit Operatori Ekonomik futet në penale nëse ka tejkalim të ditëve. Nëse ka tejkalim të ditëve dhe Operatori Ekonomik nuk është fut në penale atëherë Menaxheri duhet të jep një arsyetim për mos futje në penale.</p>
Monitorimi	19.1	Zyrtari Ligjor në Zyrën e Prokurimit (Juristi) obligohet që monitorimin e kontratës në aspektin Ligjor herë pas here ta kryej konform neneve të kontratës dhe ligjeve në fuqi dhe duhet të bindet se kontrata implementohet ashtu edhe si është hartuar. Poshtu merrë përsipër së bashku me Avokatin komunal të përballet edhe me pengesat eventuale dhe mbrojtjen e kontratës dhe interesave të Komunës para institucioneve tjera.
Parapagimi	20.1	Shuma e parapagimit (avans) : 0
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: 0 %
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	21.2	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e shërbimeve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Shërbimeve, është plus 10 % e vlerës së kontratës ose nëse dëmi është i madh deri në vlerën e përgjithshme të kontratës. Poashtu nëse kontrata ndërpritet me fajin e Autoritetit kontraktues atëherë Menaxheri jep urdhër për pagesë për të gjitha shërbimet e kryera dhe të papaguara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	21.3	Këshilli i pavarur ndërmjetësues ose Dhoma e avokatëve ose të ngajshëm

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	22.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [gjykaten kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë. Ose b) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të në pajtim me rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkontrolluese të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkontrolluese, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkontrolluese).
Mbikëqyrja	22.2	Mbikëqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marë pjesë në vlerësimin e ofertave.
Shërbime shtesë	22.3	Do të ecet me procedurë për punë shtesë nëse paraprakisht merret autorizimi nga Mbikëqyrësi dhe ZKA-ja.
Pagesat	22.4	Të gjitha pagesat bëhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës për shërbimet e kryera do të caktohet nga Menaxheri i Projektit apo Organi mbikëqyrës.
Dorëzimi i dokumentave	22.5	Zyrtari për pagesë para se t'i kryej pagesat duhet të bindet se ju kanë ofruar të gjitha dokumentet si: <b>Plani i menaxhimit të kontratës</b> , Planin vjetor të mirëmbajtjes së rrugëve lokale gjatë sezonës dimërore, aktvendimet, procesverbalet, raportet, situacionet për shërbimet e kryera, faturat, shkresat, fletët e ditarit të shërbimeve të cilat duhet të përputhen me ditët kalendarike efektive, arsyetimin për ndryshimet eventuale të pozicioneve nga paramasa, sigurimet, etj, në të kundërten e merrë përgjegjësinë.
Arkimi i dokumentave	22.6	Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe t'i ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkua nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuarë t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.
Hyrja në fuqi	22.7	Kontrata hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të palëve ose si ditë zyrtare do te konsiderohet dita kur Menaxheri jep urdher per fillimin e shërbimeve. Kontrata hartohet në 3 kopje origjinal. Vendimi mbi caktimin e Menaxherit dhe Plani i menaxhimit duhet të hartohet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës por asesi pas fillimit të shërbimeve.  Kontrata hynë në fuqi me <b>16/11/2018</b> dhe përfundon në datën <b>31/03/2019</b> .

Kësaj kontrate i bashkangjitet: Oferta financiare e Tenderuesit (Paramasa dhe parallogaria e çmimeve).

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	<b>MENSUR</b>	Emri:	<b>MEHDI GJOKA</b>
Pozita:	<b>ZYRTARI</b>	Pozita:	<b>DREJTOR</b>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<b>16/11/2018</b>	Data:	<b>16/11/2018</b>
Vula:		Vula:	



